

# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

## Nëntor 2017


**Tiranë, më 21 Dhjetor 2017:** Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Nëntor 2017 është 628.715. Krahasuar me Nëntor 2016, ky tregues rezulton me rritje 15,5 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 256.216. Krahasuar me Nëntor 2016, ky numër është rritur me 21,8 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në njëmbëdhjetëmujorin e 2017 është 4.860.226, duke u rritur me 7,8 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Në Nëntor 2017, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe me 5 herë, ndërsa uljen më të madhe e kanë patur shtetasit nga Greqia me 11,6 %.

Në njëmbëdhjetëmujorin e 2017, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe 75,9 % dhe rënie kanë patur vetëm hyrjet nga Kosova me 19,1 % (shih tab 2.)

**Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri**



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë muajit Nëntor 2017, janë 705.760 duke shënuar një rritje me 21,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Nëntor 2017, është 418.792. Krahasuar me Nëntor 2016, ky numër është rritur 13,3 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në njëmbëdhjetëmijorin e 2017 është 4.787.152, duke u rritur 6,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Hyrjet e shtetasve të huaj dhe shqiptarë në muajin Nëntor 2017, në rrugë tokësore zënë peshën më të madhe të hyrjeve gjithsej me 81,7 %, ndërsa hyrjet në rrugë ajrore zënë 14,0% dhe detare zënë 4,4 %.

**Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj**

Periodha	Nëntor-16	Nëntor-17	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Nëntor 16	Janar-Nëntor 17	Ndryshimi vjetor progresive (%)
<b>Hyrje gjithsej</b>	<b>544.425</b>	<b>628.715</b>	15,5	<b>8.644.269</b>	<b>9.227.637</b>	6,7
Shqiptarë	334.048	372.499	11,5	4.134.448	4.367.411	5,6
Të Huaj	210.377	256.216	21,8	4.509.821	4.860.226	7,8
<b>Dalje gjithsej</b>	<b>579.745</b>	<b>705.760</b>	21,7	<b>9.010.451</b>	<b>9.746.656</b>	8,2
Shqiptarë	369.672	418.792	13,3	4.498.453	4.787.152	6,5
Të Huaj	210.073	286.968	36,6	4.511.998	4.959.504	9,9

**Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj**

Shtetet	Nëntor-16	Nëntor-17	Ndryshim mujor në %	Janar-Nëntor 16	Janar-Nëntor 17	Ndryshim vjetor në %
Kosovë	67.300	93.899	39,5	2.092.506	1.692.216	-19,1
Maqedoni	33.021	35.604	7,8	531.953	604.344	13,6
Greqi	31.096	27.499	-11,6	375.416	454.722	21,1
Itali	17.091	21.451	25,5	240.004	337.737	40,7
Angli	4.100	4.479	9,2	96.079	121.027	26,0
Mali i zi	24.215	30.099	24,3	300.182	353.991	17,9
Poloni	437	2.044	367,7	65.621	115.400	75,9
SHBA	3.362	4.048	20,4	78.474	93.792	19,5
Gjermani	2.999	3.709	23,7	79.337	115.763	45,9
Zvicër	917	974	6,2	34.707	51.655	48,8
Të tjera	25.839	32.410	25,4	615.542	919.579	49,4
<b>Gjithsej</b>	<b>210.377</b>	<b>256.216</b>	<b>21,8</b>	<b>4.509.821</b>	<b>4.860.226</b>	<b>7,8</b>

**Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**

Periudha	Nëntor-16	Nëntor-17	Janar-Nëntor 16	Janar-Nëntor 17
<b>Hyrje Shtetas të Huaj</b>	210.377	256.216	4.509.821	4.860.226
I. Personale	204.756	249.651	4.456.917	4.796.933
1. Pushime	30.950	54.900	1.886.462	2.318.295
2. Vizitë në miq e të afërm	784	1.193	17.373	17.775
3. Vizitë ditore	11.945	20.341	502.961	285.781
4. Trajtim shëndetësor	40	155	612	615
5. Qëllime fetare	209	70	1.016	572
6. Vizitorë të tjerë	153.135	162.309	1.904.530	2.010.000
7. Udhëtarë tranzit	7.693	10.683	143.963	163.895
II. Biznes dhe profesionale	5.621	6.565	52.904	63.293

**Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit**

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Nëntor - 2016	83.534	25.328	435.563	92.230	25.676	461.839
Nëntor -20 17	87.763	27.515	513.437	99.474	28.033	578.253
Ndryshimi vjetor (%)	5,1	8,6	17,9	7,9	9,2	25,2
Janar-Nëntor 2016	988.595	593.761	7.061.913	994.007	666.106	7.350.338
Janar-Nëntor 2017	1.190.961	704.461	7.332.215	1.231.404,0	756.153	7.759.099
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	20,5	18,6	3,8	23,9	13,5	5,6

# Metodologji

## Përkufizime

**Vizitorë:** Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet :** Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

*Kategoria e biznesit* përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.